



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në respektim të nenit 8 paragrafi 3, pika 3.2 të Rregullores së MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe në bazë të nenit 8, pika 5, nën-pika 5.2 të Rregullores (KKV) 01 nr.144/18 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik -OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizik, shpallet kjo:

### THIRRJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e dy anëtarëve ekspert të jashtëm në komisionin vlerësues për financim të personave juridik - OJQ-ve në fushën e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale

Të interesuarit duhet të jenë ekspert të fushës së shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale.

Njëri nga kandidatët duhet të jetë ekspert jashtë institucional ndërsa kandidati tjetër duhet të jetë përfaqësues i një OJQ-je të Komunës që nuk ka aplikuar për financim të projektit të saj në bazë të thirrjes publike datë 13.08.2020.

Anëtarët që aplikojnë për tu përzgjedhur, do të jenë pjesë e komisionit vlerësues cili do të ketë për detyrë të shqyrtoj dhe vlerësoj aplikacionet për përfitim të mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, bazuar në thirrjen publike të shpallur me datën 13.08.2020

Kandidatet përves kërkesës për të u anëtarësuar në komision vlerësues duhet bashkangjitur edhe një CV të tij.

Kërkesa për anëtarësim në komisionin vlerësues në bazë të kësaj thirrje publike duhet të dorëzohen në zyrën pritëse të Komunës së Vushtrrisë, për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Afati i fundit i aplikimit është shtat (7) ditë nga dita e shpalljes.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës